



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 81 /2024
Datë: 30 janar 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 3 të Rregullores Nr.01/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.09/2015 për zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Këshillit Prokurorial, në takimin e mbajtur më datë 30 janar 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Z. Ardian Hajdaraj, anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorisë Themelore në Pejë, zgjedhet Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës, me mandat dy (2) vjeçar, e zgjedhja në këtë funksion nuk e zgjat mandatin e anëtarit të Këshillit.
- II. Z. Ardian Hajdaraj do të pezullojë pozitën e prokurorit në Prokurorinë Themelore në Pejë, gjatë periudhës së ushtrimit të pozitës të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- III. Z. Ardian Hajdaraj do të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në bazë të legjislacionit në fuqi.
- IV. Z. Ardian Hajdaraj ka të drejtë në shfrytëzimin e beneficioneve që rrjedhin nga ushtrimi i pozitës të Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- V. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.


Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- z. Ardian Hajdaraj;
- Kryeprokurorit të PTH Pejë;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- NJSHPP;
- Arkivit të KPK-së.